



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 167/2 Prot.

Patos, më 27.02 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 27 SHKURT 2024

Vendi: "Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak"

Ora e fillimit : 10 :00

Ora e mbarimit : 11: 30

Tema e Konsultimit: "Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029"

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit me nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18; Ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 4 neni 52, ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik" ligji nr. 75/2019 "Për rininë" si dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.

Pjesëmarrës: Sekretare e Këshillit të Bashkisë znj. Refaela Xeba, anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, Përfaqësues të ARM-së Fier znj. Valbona Grëmi, Drejtorja e Stacionit të Policisë Patos z. Arben Turtulli dhe rreth 35 qytetarë të bashkisë Patos dhe Njësi Administrative Zharrez dhe Ruzhdije.

Takimin hapet nga Sekretare e Këshillit të Bashkisë:


Sekretare e Këshillit të Bashkisë -- të nderuar pjesëmarrës më lejoni së pari t'ju falenderoj në emër të Këshillit të Bashkisë për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ me temë: "Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029" i cili realizohet në zbatim të ligjit me nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18; Ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 4 neni 52, ligjin nr. 9774

I | Page

datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, *ligji nr. 89/2022 “Për policinë Bashkiakë”, ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”* si dhe Rregullores së Këshilli Bashkiak “Për konsultimin publik”. Lidhur mbi këtë temë kemi prezent edhe përfaqësuesit e ekzekutivit të cilët do të na prezantojnë materialin lidhur mbi këtë plan, ku konstaton ai dhe rëndësia e zbatimit të tij, pas mbarimit të prezantimit jeni të lutur të bëni pyetje komente apo rekomandime lidhur mbi planin e menaxhimit të Zhurmave. Fjala Për ekzekutivin

	<p>Sekretare e Këshillit të Bashkisë znj. Refaela Xeba</p> <p>Dëgjesë Publike me temë :</p> <p>“Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029”</p> <p>Shkurt 2024</p>
---	--

Përgjegjëse e Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, Blerina Laçi : - Faleminderit, padiskutim që plani lokal i menaxhimit të zhurmave në mjedis është një dokument afatmesëm që në momentin e miratimit të tij do gjejë shtrirje në të gjithë territorin e bashkisë Patos dhe dy njësi administrative Zharrëz dhe Ruzhdije. Padiskutim që ky plan ka për qëllim marrjen e masave të domosdoshme për menaxhimin e zhurmës mjedisore, ndaj të cilës ekspozohen njerëzit, në zonat urbane, rurale, në parqet publike, në fusha të qeta në vendet e hapura, afër shkollave, spitaleve dhe objekteve dhe fusha të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave etj. Gjithashtu plani do të analizojë dhe parashikojë masa ligjore, administrative dhe organizative

	<p>Përgjegjës e Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit znj. Blerina Laçi</p> <p>Dëgjesë Publike me temë :</p> <p>“Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029”</p> <p>Shkurt 2024</p>
---	---

të domosdoshme për t'u ndërmarrë në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 50, datë 22.06.2023 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", ligjit nr. 89, datë 22.12.2022 "Për Policinë Bashkiake" me synimin e administrimit të qëndrueshëm dhe reduktimit të nivelit të zhurmave në mjedis dhe ndër objektivat kryesore të Planit Lokal të Menaxhimit mbi Zhurmat përfshihen: Fuqizimi institucional i Bashkisë Patos për menaxhimin e zhurmave; Përmirësimi i infrastrukturës për reduktimin e zhurmave dhe Zbatimi i masave për kontrollin e zhurmës.

Përgjegjës e Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, Blerina Laçi - prezanton "Planin Lokal të Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis për vitet 2024-2029"

Anëtarë i Këshillit të Bashkisë Z. Klaudio Alisinanaj – unë e kam parë materialin i cili është edhe i publikuar nga ekzekutivi dhe mendoj se është tepër i qartë dhe i strukturuar me detaje padiskutim që edhe prezantimi i ekzekutivit për ata që nuk e kanë parë materialin si draft mendoj se ishte tepër i qartë.



**Anëtarë i Këshillit Bashkiak
z. Klaudio Alisinanaj**

Dëgjuesë Publike me temë :
"Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave
në Mjedis 2024-2029"

Shkurt 2024

Kryetar i fshatit Rerës z. Shaban Ruçaj – unë ju falenderoj për prezantimin por doja të dija se çfarë mase konkretisht do të merret pasi ju përmendët vetëm gjobat. Konkretisht çfarë mase do të merret lidhur mbi problemin tonë si qytetar.




**Kryetar i fshatit Rerës
z. Shaban Ruçaj**

Dëgjuesë Publike me temë :
"Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave
në Mjedis 2024-2029"

Shkurt 2024

Kryetar i fshatit Rerës z. Shaban Ruçaj – patjetër që e kuptoj këtë fakt por zhurmat dhe lëkundjet nuk kanë të sosur.

Anëtarë i Këshillit të Bashkisë Z. Klaudio Alisininaj – lidhur mbi blerjen aparaturës për matjen e zhurmave mendoj që të blihet vetëm një aparaturë të cilën ta përdori policia e shtetit pasi ligji nuk na detyron blerjen e tij por na detyron të bëjmë monitorimin.

	<p>Anëtarë i Këshillit Bashkiak z. Klaudio Alisininaj</p> <p>Dëgjesë Publike me temë : “Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029”</p> <p>Shkurt 2024</p>
---	--

Përgjegjës e Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, Blerina Laçi – nga ana e ministrisë ka ardhur kërkesa për blerjen e aparaturës për matjen e zhurmave.

Anëtarë i Këshillit të Bashkisë Z. Klaudio Alisininaj – në gjykimin tim plani ishte i detajuar por mendoj se bashkia duhet të hartoj plan masash të detajur me pesë pika të specifikuar për marrjen e masave nga ana e saj.

Shef i Stacionit të Policisë Patos z. Arben Turtulli - në lidhje me parafolësit sipas udhëzimit është i qartë dhe qëllimi është që të gjitha strukturat të bashkëveprojnë sëbashku. Problemi më i madh është aparatura që do të përdoret pasi duhet jetë e certifikuar dhe duhet

	<p>Shef i Stacionit të Policisë Patos z. Arben Turtulli</p> <p>Dëgjesë Publike me temë : “Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029”</p> <p>Shkurt 2024</p>
---	--

të ketë burime njerëzore të specializuara në përdorimin e saj duke mos harruar këtu se aparaturo duhet të jetë e kolauduar pasi mund të kemi edhe raste ankimi nga ana e qytetarëve apo subjekteve. Deri tani policia e ka trajtuar ankesat e ardhura nga qytetarët dhe po të përmendim rastin e përdorimit të lëndëve piroteknike vitin e kaluar nga ana e policisë situata është mbajtur nën kontroll. Por unë përsëri dua ta vë theksin në bashkëpunimin e instancave bashki, polici e shtetit, polici bashkiake, qytetar, kryetar fshati etj.

Përgjegjës e Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, Blerina Laçi – patjetër që aparaturo në momentin e blerjes së saj do të jetë e certifikuar dhe kolauduar.

Shef i stacionit të policisë Patos z. Arben Turtulli- nuk duhet të mbetemi vetëm te policia e shtetit por duhet të ketë bashkëpunim mes aktorëve që sapo përmenda.

Anëtarë i Këshillit të Bashkisë Z. Erald Çepele – jam dakort me parafolësin ku theksin duhet ta vendos si tek ndotja mjedisore ashtu edhe tek ndotja akustike se është në radhë të parë një detyrim qytetar dhe mendoj se duhet të punohet në këtë drejtim dhe institucionet duhet të marrin masa shtrënguese.



**Anëtarë i Këshillit Bashkiak
z. Erald Çepele**

Dëgjesë Publike me temë :
“Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave
në Mjedis 2024-2029”

Shkurt 2024

Kryetar i fshatit Frashër z. Irakli Zarka – kemi probleme me ndotjen e mjedisit dhe ju si bashki duhet të merrni masa për ndotjen e shkaktuar.



**Kryetar i fshatit Frashër
z. Irakli Zarka**

Dëgjesë Publike me temë :
“Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në
Mjedis 2024-2029”

Shkurt 2024

Përfaqësues i ARM-së znj. Valbona Grëmi - për cilën zonë bëhet fjalë.

Përgjegjës e Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, Blerina Laçi –bëhet fjalë për fshatin Frashër por ka institucione të tjera të cilat merren me dhënie e gjobave apo masave shtrënguese deri në heqjen e licencave. Roli i bashkisë është vetëm konstatimi i situatës dhe delegimi i saj në instanca të tjera.

Shef i stacionit të policisë Patos z. Arben Turtulli- qysh në momentin që kam kaluar në këtë pozicion në stacion nuk ka ardhur asnjë ankesë lidhur mbi shqetësimin tuaj ndaj ju sygjeroh që të paraqiteni tek stacioni i policisë për marrjen e ankesës.



**Shef i Stacionit të Policisë Patos
z. Arben Turtulli**

Dëgjesë Publike me temë :
“Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave
në Mjedis 2024-2029”

Shkurt 2024

Kryetari i fshatit Zharrëz z. Bexhet Rredhi - ne jemi dakort me planin dhe ajo që ka më shumë rëndësi është zbatueshmëria e tij pasi zona jonë ka lokale të cilat bëjnë dasma edhe ditën edhe natën dhe përdorin muzike të lartë dhe fishekzjarre.




**Kryetari i fshatit Zharrëz
z. Bexhet Rredhi**

Dëgjesë Publike me temë :
“Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave
në Mjedis 2024-2029”

Shkurt 2024

Anëtar i pleqësisë për fshatin Dukas z. Isuf Bregu – ne si lagje jemi plotësisht dakort me planin e hartuar nga bashkia dhe të filloj puna sa më shpejtë për zbatimin e tij suksese bashkisë.

	<p>Anëtar i pleqësisë për fshatin Dukas z. Isuf Bregu</p> <p>Dëgjuesë Publike me temë : “Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029”</p> <p>Shkurt 2024</p>
---	--

Përgjegjës e Sektorit të Pyjeve dhe Mjedisit, Blerina Laçi – Plani i detajuar ka të parashikuar edhe përdorimin e fashave të kufizimit të orareve të përdorimit të cilat janë të përcaktuara me ligj dhe VKM të vecantë.

Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba – duke ju faleminderuar për çdo pyetje apo koment tuajin nëse nuk keni gjë tjetër për të shtuar e deklaroj këtë takim konsultativ të mbyllur. Edhe një herë faleminderit

Konceptoi:

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj



Pranoi:

Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba



Foto të dëgjesës publike me temë: “Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029”

